



**REPUBLIKA E SHQIPERISE**  
**BASHKIA KAMEZ**

**Punuan:**  
**Ing. Hajredin MURGU**  
**Ing. Skënder SELITA**



**MIRATOI**  
**Xhelal MZIU**

---

**K R Y E T A R**

**R A P O R T   T E K N I K**

**OBJEKTI:            REHABILITIMI I DIGES LIQENI I PASKUQANIT**  
**BASHKIA KAMEZ**

## I.- HYRJA

Ujembledhesi i Paskuqanit eshte nje nga te shumtat vepra ujtese te ndertuara ne Paskuqan.Vepra eshte ndertuar ne vitin 1983 me dige te tipit homogjene me lartesi rreth 27.8 m.Ka nje kapacitet ujembledhes prej 9.000.000 m<sup>3</sup> dhe mbushet me pellg shimbleshes e me me kanal ushqimi nga Lumi i Tiranës.Vepra ka një ujeleshues, aktualisht jashte funksioni, gjysëm i bllokuar.Vepra nuk ka shkarkues katastrofik. Për këtë arsye duhet ndërhyrje urgjente duke investuar për riparimin e ujeleshuesit dhe të digës pasi rrezikohet jeta e rreth 1000 familjeve nën digë.



## II.- TE DHENA TE DETYRES SE PROJEKTIMIT

Detyra e projektimit kërkon të hartohet projekti për :

### **“ Rehabilitimi i Diges Liqenit të Paskuqanit”**

Projekti i zbatimit te hartohet sipas kushteve teknike te projektimit duke marre ne konsiderate te dhenat e mesiperme.

Te nderhyhet ne keto nenobjekte:

1-Riparimi i shkarjes ne trupin e diges

2-Riparimi i ujeleshuesit

3-Ndertimi i rruges per ne objekt

Projekti i zbatimit duhet te paraqese:

- ⇒ Planimetrine, profil gjatesor dhe profila terthore.
- ⇒ Veprat e Artit te domosdoshme per mirefunksionimin e vepres.
- ⇒ Relacionin teknik
- ⇒ Preventivin e punimeve
- ⇒ Specifikimet teknike

Cmimet e preventivit janë hartuar me manualin date 629 dt 15.07.2015.

## III.- RELACIONI TOPOGRAFIK

Nga rikonicioni i kryer ne vend dhe konsultimi me specialistet e Bordit te Kullimit verejme se eshte e domosdoshme te kryhen punime per Rehabilitimin e diges **“ Rehabilitimi i Diges Liqenit të Paskuqanit”** .

Matjet topografike u kryen duke u mbeshtetur ne rrjetin shteteror koordinativ, duke iu

pershtatur kerkesave te dhena ne termat e references nga ing topografeve i shoqeruar nga inxhinieri hidroteknik. Saktësia e realizuar në matje është +- 1 cm në plan dhe +- 1.5 cm në kuotat për një rreth me rreze 5 000 metra (ose diametër 10 000 metra). Kjo saktësi është maksimalisht e mjaftueshme për kërkesat teknike të projektit. Pas perfundimit te matjeve ne terren u be perpunimi i matjeve topografike dhe hartimi i dokumentacionit te duhur.

#### IV.- RELACIONI GJEOLGJIK

Nga rikonicioni i kryer ne vend dhe konsultimi me specialistet e Bordit te Kullimit verejme se eshte e domosdoshme te kryhen punime per Rehabilitimin e diges “ **Rehabilitimi i Diges Liqenit të Paskuqanit**” Gjate inspektimit te kryer ne objekt u konkludua se shkarja e ndodhur nuk ka shkaqe te brendeshme por ka ardhur si rezultat i filtrimeve te vazhdueshme prej shume vitesh nga ujeleshuesi dhe nga shirat siper digës

#### V.- ZGJIDHJA TEKNIKE E PROJEKTIT

Objekti ndahet ne kater nenobjekte :

- 1-Riparimi i shkarjes ne trupin e diges
- 2-Riparimi i ujeleshuesit
- 3-Ndertimi i rruges per ne objekt

#### RIPARIMI I SHKARJES NE TRUPIN E DIGES

Duke pare se shkarja nuk ka ardhur si rezultat i filtrimeve te trupit te diges por nga shkaqe te jashteme qe i spjeguem me lart grupi i projektimit per eleminimin e saj ka parashikuar si me poshte :

Do te pastrohet i gjithë materiali ne zonen e shkarjes.Do te krijohen dhembesime ne pjesen e kontaktit te zones se shkarjes me pjesen tjeter te trupit te diges.Do te ndertohet nje kontrabankine ne pjesen fundore te trupit te diges duke e mbeshtetur ne gabiona te inkastruar mire. Pastaj do te mbushet trupi i diges deri ne pjerresine e projektit te pjeses tjeter te diges.Mbushja do te behet me dhe duke e ngjeshur me rrul me dhembe me shtresa çdo 20 cm. Gjithashtu projekti ka parashikuar dhe sjelljen ne kushte projekti te kurores se diges duke bere me pare skarifikimin e saj dhe pastaj mbushjen sipas kushteve teknike.

Projekti ka parashikuar mbjelljen me bar te zones se shkarjes ku do te kryhen punime.

#### RIPARIMI I UJELESHUESIT

Projekti ka parashikuar riparimin e ujeleshuesit. Do te behet riparimi i mekanizmit te hapjes dhe mbylljes se ujit.

#### NDERTIMI I RRUGES PER NE OBJEKT

Projekti ka parashikuar nderhyrje ne rreth 500 ml te kesaj rruge duke bere germimin me makineri dhe shtrimin e saj me 20 cm çakell me gjeresi 6 m.Do te behet dhe kanal anesor me krah.Pjese e projektit te kesaj eshte dhe ndertimi i nje pedonalje ne krye të digës me gjeresi 5m.

#### VI.- ORGANIZIMI I PUNIMEVE

Për ndërtimin e objektit ““ **Rehabilitimi i Diges Liqenit të Paskuqanit**”” ,projekti parashikon të përdoren materiale të cilësisë së lartë sipas standarteve të vendit dhe ndërkombëtare dhe të zbatohen me rigorozitet Kushtet Teknike të Zbatimit të punimeve.

Punimet do te fillojne nga rruga per ne objekt.Rekomandohet qe punimet per riparimin e ujeleshuesit te kryhen pas sezonit te ujitjes pasi domosdoshmerisht duhet te kryhen ne mungese te ujit.

Gjate ndertimit të këtij objekti të kihet parasysh gjithashtu:

- 1.- Betonet janë parashikuar të jenë të markës C 12/15 dhe C16/20.
- 2.- Të gjitha betonet janë parashikuar të formohen me betonforma.
- 3.- Nuk do të hidhet beton pa përdorur vibratorin, qofte ate te thellesise apo ate siperfaqesor.

Materialet e objektit do te merren ne prodhuesit qe plotesojne kerkesat e specifikimeve teknike. Materialet inerte per betonet do te merren ne nyjet e fraksionimit qe ndodhen ne afersi te zones.

### VIII.- PREVENTIVI

Preventivi është hartuar ne baze te VKM 568, dt.27.06.2013, dhe vlera e plote është **53 346 028** leke me TVSH.

Preventivi është hartuar ne baze të me manualit të VKM 629 datë 15.07.2015.

**RAPORTI TEKNIK U KRYE NGA**  
**ING. Hajredin MURGU dhe ING.Skënder SELITA**

